

Mbahet ceremonia përmbyllëse e projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri”

Në kuadër të përmbylljes së projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) i Zvicrës, më datë 23 Dhjetor 2024, në ambientet e Hotel Plaza, u organizua ceremonia përmbyllëse, ku ishte i ftuar zv. Ambasadori Zvicerian z. Philipp Arnold, stafi drejtues i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe audituesit e përfshirë në auditimet pilot, si dhe organizata e shoqërisë civile bashkëpunëtoare e KLSH-së, Instituti për



Demokrasi dhe Ndërmjetësim (IDM Albania), me përfaqësues z. Sotiraq Hroni dhe znj. Rovenia Sulstarova. Pjesë e kësaj ceremonie ishte edhe eksperti i jashtëm RSM Albania, i cili ka asistuar në vijimësi audituesit e KLSH-së për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve lidhur me teknikat e auditimit në fushën e koncesioneve/PPP-ve.

Në fjalën e mbajtur, zv. Ambasadori Zvicerian z. Arnold, theksoi rëndësinë dhe ecurinë e suksesshme të bashkëpunimit me KLSH-në në fushën e auditimit të koncesioneve/PPP-ve, si një kontribut me vlerë në auditimin e menaxhimit të fondeve publike. Ky bashkëpunim vlerësohet të ketë ndikuar në përmirësimin e teknikave të auditimit si dhe në rritjen e mëtejshme të kapaciteteve audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga ana e znj. Valbona Gaxha në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH-së dhe njëkohësisht të Kryetarit të Njesisë së Implementimit të Projektit, u nënvizua se bashkëpunimi i frytshëm në kuadër të këtij projekti ka hedhur themele për bashkëpunime të mëtejshme, për të garantuar vijimësinë e forcimit të kapaciteteve në këtë fushë dhe më gjerë, duke mbështetur kështu edhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit publik në Shqipëri.





Nga ana e RSM Albania u prezantua Manuali i Auditimit të Koncesioneve/PPP-ve si një dokument me vlerë i cili paraqet të gjitha proceset dhe teknikat e auditimit të përdorura për auditimin e kontratave të koncesionit/PPP, siç identifikohen nga praktikat më të mira dhe rekomandohen nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Kjo ceremoni shërbeu si shënjimi përmbyllës i projektit, duke finalizuar me sukses rezultatet e tij që nga përfundimi i auditimeve pilot, zhvillimi i vizitës studimore në një SAI me eksperiencë në fushën e auditimit të kontratave koncesionare/PPP-ve, si dhe hartimin dhe miratimin e Manualit të Auditimit të Koncesioneve/PPP-ve, asistuar nga eksperti RSM Albania.

